

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.8765, datë 2.4.2001

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8113,
DATË 28.3.1996 "PËR DEKORATAT NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës,
me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalëve "shtetasve shqiptarë ose të huaj", shtohen fjalët "
si dhe personave juridikë,".

Neni 2

- Në nenin 3 pika 4, emërtimi "Mjeshtër i Madh i Punës" ndryshohet në
"Mjeshtër i Madh".

-

- Në po këtë nen shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:
"11. Medalja "Për Merita të Veçana Civile"

Neni 3

Në nenin 8 titulli ndryshohet në "Urdhri "Mjeshtër i Madh"".

Neni 4

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

"Medalja "Për Merita të Veçanta Civile"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të veçanta civile në Shqipëri.
Kjo medalje do të jetë e artë."

Neni 5

Urdhri "Mjeshtër i Madh i Punës", i dhënë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji,
njihet si Urdhri "Mjeshtër i Madh".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Skënder Gjinushi